



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA KOMERCIALE

Numri i lëndës: 2024:043289

Datë: 22.08.2024

Numri i dokumentit: 06077973

KE.nr. 2768/22

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, gjyqtari Arnis Dumani, në çështjen juridike të paditësit “KCC” SH.P.K., me seli në Prishtinë, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson Shoqëria e Avokatëve “Avokatura Istrefi”, me seli në Prishtinë, kundër të paditurit Kompania e Sigurimeve “Scardian”, me seli në Prishtinë, me objekt kontesti kompensim dëmi, jashtë seancës, më datë 22.08.2024, merr këtë:

A K T V E N D I M

KONSTATOHET se është tërhequr padia e paditësit “KCC” SH.P.K., me numër KE.nr.2768/22 e datës 25.07.2024, me objekt kontesti kompensim dëmi nga aksidenti i datës 11.05.2022 i konstatuar sipas raportit të aksidentit 2022-AR-1284, kundër të paditurit Kompania e Sigurimeve “Scardian”.

A r s y e t i m

Paditësi “KCC” SH.P.K. me datë 07.12.2022, ka paraqitur padi për shpërblimin e dëmit mbi bazën e sigurimit të detyrueshëm nga auto përgjegjësia lidhur me aksidentin e datës 11.05.2022 i konstatuar sipas raportit të aksidentit 2022-AR-1284.

Me datë 25.07.2024, paditësi me anë të parashtresës, e ka njoftuar Gjykatën se për këtë çështje juridike e tërheqë padinë, për arsye se me të paditurin kanë arritur pajtim jashtë gjyqësor.

Gjykata duke vepruar sipas parashtresës së paditësit, në kuptim të nenit 261 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, vendosi si ne dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Parë - Departamenti për Çështje Ekonomike

KE.nr.2768/22, datë 22.08.2024

Gjyqtari
Arnis Dumani

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi, bazuar në nenin 261 par. 4 të LPK-së, nuk është e lejuar ankesa.